

TRANSPARENCA DHE PËRGJEGJËSIA NË NIVEL VENDOR

VLERËSIMI I PROCESEVE TË KONSULTIMIT PUBLIK NË BASHKINË PUKË 2024

**PËRGATITUR NGA:
LËVIZJA RINORE PËR DEMOKRACI
RRJETI PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE**

Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik

Bashkia “Pukë”

Përgatiti: Qendra “Lëvizja Rinore për Demokraci” Pukë

Korrik 2024

Tabela e Përmbajtjes

TABELA E PËRMBAJTJES	3
1. LISTA E SHKURTIMEVE	4
2. HYRJE.....	5
3. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E STUDIMIT	7
4. METODOLOGJIA E STUDIMIT	8
5. KUADRI LIGJOR NË NIVEL VENDOR	11
6. PËRSHKRIMI I STRUKTURËS SË QEVERISJES LOKALE NË BASHKINË PUKË:	12
7. HISTORIKU I PROCESIT TË NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË BASHKINË PUKË	14
8. VLERËSIM I EFEKTIVITETIT DHE TRANSPARENCËS SË PROCESIT TË KONSULTIMIT PUBLIC	16
8.1 GJETJE NGA INTERVISTAT E REALIZUARA ME STAF TË BASHKISË PUKË	19
8.2 GJETJE NGA INTERVISTAT E ZHVILLUARA ME ANËTARË TË KËSHILLIT BASHKIAK.....	22
9. PËRMBLEDHJE E KOMENTEVE DHE REKOMANDIMEVE TË GRUPEVE TË INTERESIT E QYTETARËVE NGA KONSULTIMI PUBLIC	24
9.1 INTERVISTAT E THELLUARA ME GRUPET E INTERESIT	24
9.2 PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËRMES VLERËSIMIT ONLINE.....	26
10. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	31
11. REFERENCA (LISTA E BURIMEVE TË PËRDORURA PËR STUDIMIN)	32
12. ANEKSE	32
ANEKSI 1. KËRKESË ZYRTARE DREJTUAR BASHKISË PUKË	32
ANEKSI 2. PËRGJIGJE ZYRTARE NGA BASHKIA PUKË	32
ANEKSI 3. PYETËSORI I INTERVISTAVE TË THELLUARA ME STAFIN E BASHKISË PUKË	32
ANEKSI 4. PYETËSORI I INTERVISTAVE TË THELLUARA ME ANËTARËT E KËSHILLIT BASHKIAK PUKË.....	32
ANEKSI 5. PYETËSORI I INTERVISTAVE TË THELLUARA ME GRUPET E INTERESIT.....	32
ANEKSI 6. PYETËSORI PËR QYTETARËT ONLINE.....	32

1. Lista e Shkurtimeve

AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
BP	Buxheti me Pjesëmarrje
KB	Këshilli Bashkiak
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
LRD	Lëvizja Rinore për Demokraci
NED	National Endowment for Democracy
Nj.A	Njësi Administrative
NJVQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OPIC	Olof Palme International Center
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PBA	Projekt Buxheti Afatëmesëm
POP	Përballja e Ofertave Politike
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak

2. Hyrje

Angazhimi dhe përfshirja e qytetarëve në konsultim dhe vendimmarrje përbën një nga elementët kryesorë drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë, ku zëri i të gjithëve dëgjohet gjatë gjithë procesit të vendimmarrjes, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes organizatave të shoqërisë civile tek institucionet përgjegjëse. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve garanton identifikimin e problemeve dhe nevojave reale, përfshirjen e njohurive dhe përvojave të të gjithë aktorëve, duke i bërë ata të ndihen përgjegjës për çështje të përbashkëta, duke rritur besueshmërinë dhe transparencën për krijimin e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme.

Roli dhe kontributi i pazëvendësueshëm i qytetarëve dhe komuniteteve në proceset qeverisëse është kyç për arritjen e një qeverisjeje sa më demokratike, ndërkohë që bashkitë përmes zbatimit efektiv të ligjit dhe politikave të duhura e gjithëpërfshirëse sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm, përfshirje dhe kohezion social.

Është misioni i qeverisjes vendore të sigurojë një administrim sa më pranë qytetarëve të saj dhe të nxisë pjesëmarrjen e tyre efektive në të, ndërkohë që ushtrimi i qeverisjes dhe përmirësimi i cilësisë së jetës nuk mund dhe nuk duhet të jenë e drejtë ekskluzive e saj. Për sa kohë që ekzistojnë mekanizma dhe modele të mirëqeverisjes, bashkitë duhet të vijojnë të kërkojnë, adaptojnë e praktikojnë alternativa dhe forma ku qytetarët, grupet e interesit dhe shoqëria civile shihen si partnerë të domosdoshëm të këtij procesi.

Studimi “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik” zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikën e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Ai zhvillohet nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike”¹ (POP) në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financuar nga National Endowment for Democracy dhe Olof Palme International Center.

Rrjeti POP përmes këtij programi synon të përmirësojë qeverisjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve publike, si dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) për të ndikuar në proceset e politikave të përfaqësuesve të tyre vendorë bashkiakë.

Organizatave anëtare të Rrjetit POP, veprojnë si grupe presioni për të advokuar në qeveritë e tyre vendore për të identifikuar prioritetet e zhvillimit, në mënyrë që politikën dhe programet të bazohen në nevojat lokale, si dhe në mundësitë dhe kapacitetet e disponueshme.

Nën këtë optikë në periudhën maj – qershor 2024, është realizuar studimi “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik”. Studimi ka për qëllim

¹ Faqe zyrtare e Rrjetit POP: <https://popnetwork.al/>

të vlerësojë situatën në 10 bashkitë

e targetuara² për periudhën shtator 2023 – maj 2024, për të pasqyruar situatën e realizimit të njoftimit dhe konsultimit publik në këto njësi të qeverisjes vendore. Gjetjet dhe rekomandimet do të shërbejnë për të marrë një informacion më të thelluar për mekanizmat e identifikuar të Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit në nivel vendor, sfidat, vështirësitë dhe rastet e suksesit në zbatimin e tij. Rrjeti POP në një fazë të mëvonshme do të punojë dhe me institucionet mbikqyrëse për të ndarë gjetjet e studimit, siç janë Prefekturat, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioritetëve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

<ul style="list-style-type: none"> • Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë; • Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës; • Qendra Rinore Vlorë, • Epoka e Re, Fier; 	<ul style="list-style-type: none"> • Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër; • Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë; • Qendra për Progres Rinor, Kukës, • Gruaja në Zhvillim, Korçë; • Hapa të Lehtë, Vau i Dejës; • Tjetër Vizion, Elbasan
----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

² Tiranë, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë

3. Përmbledhje Ekzekutive e Studimit

Përgatitja e këtij raporti është bërë nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” (POP) në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financuar nga National Endowment for Democracy dhe Olof Palme International Center. Rrjeti POP përmes këtij programi synon të përmirësojë qeverisjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve publike, si dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve për të ndikuar në proceset e politikave të përfaqësuesve të tyre vendorë bashkiakë.

Në Pukë, studimi është përgatitur nga Qendra LRD, organizatë anëtare e Rrjetit POP, me synimin kryesor që organizatat lokale të veprojnë si grupe presioni për të advokuar në qeveritë e tyre vendore për të identifikuar prioritetet e zhvillimit, në mënyrë që politikat dhe programet të bazohen në nevojat lokale, si dhe në mundësitë dhe kapacitetet e disponueshme.

Studimi “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik në Pukë” vlerësoi situatën e realizimit të ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik për periudhën shtator 2023 – maj 2024, përmes monitorimit të dëgjësave publike duke nxitur diskutimin midis aktorëve të përfshirë për njohjen dhe zbatimin e ligjit, si dhe përgatiti disa rekomandime konkrete në nivel të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV)

Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në vendimmarrje përfaqëson një nga format kryesore të angazhimit të qytetarëve në jetën publike. Kjo arrihet përmes mjeteve dhe mekanizmave që NJVQV ushtrojnë, në përputhje me Ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik³ duke vënë në dispozicion të qytetarëve, hapësira dhe mundësi për t'i përfshirë ata në formulimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, programeve dhe shërbimeve për komunitetin. Pavarësisht se të gjithë të intervistuarit e vlerësonin rëndësinë e proceseve konsultuese dhe gjithëpërfshirëse, realizimi efektiv i tyre në nivel vendor mbetet ende një sfidë.

Gjetjet kryesore:

- Bashkia dhe Këshilli Bashkiak (KB) Pukë, duhet të demonstrojnë përgjegjshmëri në kryerjen e detyrave të tyre me efikasitet, efektivitet dhe transparencë, në përputhje me ligjin dhe interesin publik.
- Komuniteti dhe veçanërisht shoqëria civile, nga ana e tyre, duhet të përfitojnë dhe përdorin me mençuri këto mekanizma, duke ushtruar rolin e tyre të domosdoshëm dhe

³ Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik: <https://qgz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e>

fuqinë që ligji iu jep në sigurimin e një qeverisjeje të drejtë, transparente dhe të orientuar drejt qytetarit.

- Mobilizimi dhe angazhimi aktiv i qytetarëve në nivel vendor, debati i hapur, ndarja dhe shkëmbimi i përvojave dhe ideve të ndryshme, si dhe shqyrtimi i të gjitha alternativave të mundshme, duhet të jenë reale dhe jo sa për procedurë dhe fasadë, por duhet të realizohet në të gjitha fazat që ligji parashkon duke mundësuar një vendimarrje të shëndetshme dhe gjithëpërfshirëse për çdo bashki.
- Njohja dhe zbatimi efektiv i ligjit, synon të sigurojë transparencën e munguar prej vitesh, ndaj vendimarrjes së KB dhe të bashkisë, të cilët zakonisht i konsiderojnë dëgjesat publike e konsultimet me publikun, si procese që duhen bërë sa për të qënë në rregull me ligjin, e në më të shumtën e rasteve i anashkalojnë gjithë fazat e dispozitave normative, duke lënë mënjanë dhe duke përjashtuar qytetarët dhe palët të tjera të interesuara (OSHC-të), duke zvogëluar ndjeshëm hapësirat e pjesëmarrjes e për pasojë vendimet që zbatohen bëhen më të vështirë për tu pranuar nga të gjithë aktorët e komunitetit.
- Gjetjet e studimit tregojnë se qytetarët nuk kanë besim të bëhen pjesë e proceseve konsultuese si dhe në ato raste kur raportojnë që kanë qënë pjesë e tyre, ata pohojnë se zëri i tyre nuk dëgjohet, ose mjaft rekomandime nuk gjejnë zbatim.
- Midis krahasimit të kuadrit ligjor, formave të zbatuara dhe vlerësimeve të marra në kuadër të studimit të realizuar, del në pah se ligji njihet dhe zbatohet në mënyrë modeste nga ana e institucionit të bashkisë, si nga aparati ekzekutiv (stafi i bashkisë) ashtu dhe nga legjislativi (anëtarët e KB)
- Transparenca, konsultimi dhe pjesëmarrja qytetare në vendimarrjen lokale vazhdojnë të jenë sfida për autoritetet vendore, duke shërbyer në të njëjtën kohë dhe si tregues të funksionimit të demokracisë lokale.
- Zbatimi i Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik duke përcaktuar qartë se cilat projekt akte i nënshtrohen detyrimisht konsultimit publik në nivel vendor duhet të qartësojë nevojën për ndryshime ligjore dhe praktika shtrënguese për moszbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji.
- Gjithsesi grupet e interesit, OSHC-të lokale dhe qytetarët aktivë në komunitet duhet të rrisin kapacitetet duke njohur të drejtat e tyre për të ushtruar presion pozitiv dhe për tu ankuar pranë institucioneve përgjegjëse e duke u përballur edhe në gjykatë për çështje me intres të lartë publik.

4. Metodologjia e Studimit

Për përgatitjen e vlerësimit në lidhje me zbatimin e Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit publik (ligji nr. 146/2014⁴) në bashkinë Pukë, ekspertët e projektit kombinuan një sërë mjeteve dhe metodologjish duke përfshirë:

⁴ Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e>

- Analizimin e Gjetjeve të Raportit Studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik” realizuar nga Rrjeti POP në vitin 2022.⁵
- Rishikimin e dokumenteve strategjike, publikimet në regjistrin elektronik për konsultimet, publikimet në programin e transparencës, raporte të prodhuara dhe bazat e të dhënave në të gjitha fazat mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor;
- Hulumtimi i raporteve dhe mekanizmave të kontrollit të Prefekturës përkatëse; Kontrollit të Lartë të Shtetit si edhe të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) për monitorimin e zbatimit të ligjit të njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor.
- Kërkesa zyrtare për informacion drejtuar kryetarit të bashkisë.
- Përgatitjen e pyetësorëve të studimit; trajnimin e intervistuesve; 5 intervista të drejtpërdrejta me stafin e bashkive (Nën kryetar/e i/e bashkisë; Koordinatori/ja për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, Koordinatori/ja për të Drejtën e Informimit dhe Transparencën; Drejtoria e Përgjithshme Juridike; Drejtoria e Financës) si edhe 5 intervista të thelluara me anëtarë të këshillave bashkiakë (Kryetar, sekretar i KB, anetar i Komisionit Juridik, anetar i komisionit te finances, anetar i komisionit te peticioneve, mandateve dhe rregulloreve). 30 intervista të thelluara me aktivistë/përfaqësues të komunitetit dhe qytetarë (8 intervista me OJF, Biznese, aktiviste te shoqerise civile dhe 22 te tjera me qytetare nga grupet e interesit); 104 pyetësorë online si edhe përpunimin dhe analizimin e të dhënave dhe përgatitjen e raportit përfundimtar të studimit.

Burimi kryesor i informacionit në lidhje me shqyrtimin e dokumenteve strategjike, raporteve të prodhuara dhe zbatimit të fazave të procesit të njoftimit dhe konsultimit publik janë faqet zyrtare të internetit të bashkive e këshillave bashkiakë të përzgjedhura në studim, rregulloret e brendshme dhe publikimi i njoftimeve dhe dokumentacionit lidhur me konsultimet publike të zhvilluara, por edhe raportet e prodhuara nga institucione ndërkombëtare apo organizata të shoqërisë civile, etj.

Në lidhje me mekanizmat e kontrollit të zbatimit të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, ekspertët dhe organizatat e përfshira në projekt kanë hulumtuar dokumentet e prodhuara nga tre institucionet që monitorojnë drejtëpërdrejtë zbatimin e ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik si institucioni i Prefektit, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale.

Për përgatitjen e studimit ekspertët e projektit hartuan kërkesa për informacion drejtuar stafeve bashkiakë të NjVQV, pyetësorë dhe intervista të thelluara me koordinatorët e Njoftimit dhe Konsultimit Publik, sekretarët dhe anëtarët e këshillave bashkiakë stafet e bashkive dhe aktivistë qytetarë e përfaqësues të OSHC-ve. Pyetësorët përmbajnë pyetje rreth temave që lidhen me: urdhërat e brendshëm për fillimin e procedurës së konsultimit publik; përgatitja dhe publikimi i kalendarit të konsultimit publik; njoftimi i konsultimit publik; realizimi i konsultimit; përgatitja dhe publikimi i procesverbaleve, ndikimi i rekomandimeve të qytetarëve dhe grupeve të interesit në vendimet përfundimtare të aprovuara nga vendimarrësit si dhe publikimi i raportit të

⁵ Raporti Studimor POP Puke 2022 <https://popnetwork.al/raporti-studimor-informimi-njoftimi-dhe-konsultimi-publik-bashkia-Pukë/>

konsultimit publik në rregjistrin elektronik. Në lidhje me qytetarët dhe grupet e interesit përmes pyetësorëve është vlerësuar efektiviteti i procesit të konsultimit publik, si reflektohen rekomandimet e tyre dhe si ndikon në jetën e qytetarëve vendimet që nuk konsultohen me proces të pjesëmarrëse.

Pyetësorët përmbajnë pyetje cilësore dhe sasiore duke mbajtur në vëmendje ekspertizën lokale të organizatave të rrjetit POP, në çështje të qeverisjes vendore dhe angazhimit qytetar. Për përgatitjen e pyetësorve ekspertët e organizatave lokale konsideruan faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në cilësinë e sondazhit, të tilla si: objektivi i përgjithshëm i anketimit dhe konteksti lokal (të dhënat informacionet ekzistuese) për të mundësuar një kuptim më të mirë të situatës dhe çështjeve.

Gjithashtu u trajnuan 4 përfaqësues të organizatave lokale, për të zhvilluar intervistat në terren. Intervistat kërkuan të sigurojnë marrjen e informacioneve në aspektin gjeografik, të moshës dhe gjinisë. Intervistuesit zhvilluan intervista të drejtpërdrejta, duke drejtuar pyetjet personalisht dhe duke plotësuar në vend pyetësorët.

Në periudhën prill – qershor 2024, janë intervistuar 10 zyrtarë vendorë, përfaqësues të Bashkisë Pukë dhe Këshillit Bashkiak, ndërsa janë intervistuar ballë për ballë 30 (19F/11M) përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësues nga grupet e interesit që kanë qënë pjesë e dëgjësive publike në periudhën shtator 2023 - maj 2024. Gjithashtu një pyetësor i shpërndarë online është plotësuar nga 104 (61F/43M) banorë të Pukës që kanë dhënë vlerësimin e tyre mbi njohjen e perceptimin e tyre mbi njoftimin e konsultimit publik.

Pas përfundimit të intervistave u zhvillua një bazë të dhënash, për t'u përpunuar dhe u analizuar. Qendra Rinore e Pukës përgatiti një raport të hollësishëm të vëzhgimit me gjetjet dhe rekomandimet që do të përdoren në një fazë të mëvonshme për të avokuar për nevojat dhe prioritetet qytetarëve me përfaqësues të institucioneve vendore (Bashkia dhe KB). Ky raport është rezultat i punës intensive në zyrë dhe kontributit në terren nga përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, anëtare të rrjetit POP.

Një raport i përbashkët me gjetjet nga 10 bashkitë: Tiranë; Durrës; Elbasan; Pukë; Fier; Vau i Dejës; Korçë; Kukës; Shkodër e Fier do të hartohet me metodën krahasuese dhe do të shërbejë për të evidentuar progresin e arritur duke analizuar të dhënat e grumbulluara nga gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e arritura nga raporte të mëparshme duke përdorur indikatorë sasiorë dhe cilësorë si burime primare⁶ dhe sekondare⁷ për grumbullimin e informacionit.

Gjetjet dhe rekomandimet e raportit do të synojnë përmirësimin e situatës aktuale nëpërmjet masave që autoritetet vendore duhet të ndër marrin në lidhje me zbatimin e ligjit dhe propozime për ndryshime ligjore për ta bërë procesin sa më interaktiv dhe gjithëpërfshirës.

⁶ Si burimë primare të informacionit u përdor ligji nr.146/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, informacioni në lidhje me procesin e konsultimit publik të publikuar në faqet zyrtare të bashkive respektive si edhe informacioni i përfituar nëpërmjet Kërkesave për Informim.

⁷ Si burime sekondare: u përdorën raporte të tjera në lidhje me procesin e konsultimit të cilat shërbyen në përgatitjen e analizës krahasuese të progresit në çdo bashki në lidhje me procesin e konsultimit.

5. Kuadri ligjor në nivel vendor

Misioni i NJVQV është të sigurojë një administrim sa më pranë qytetarëve dhe të nxisë një pjesëmarrje efektive të banorëve në qeverisjen vendore. Transparenca, llogaridhënia dhe përfshirja publike janë parimet themelore për ruajtjen dhe avancimin e demokracisë.

Dialogu ndërmjet qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur, si dhe përfshirja e tyre në qeverisjen lokale, janë thelbësore për avancimin e demokracisë lokale, sepse forcohet legjitimiteti dhe efektiviteti i veprimeve të bashkisë dhe këshillit bashkiak. Procesi i konsultimit publik përbën një shtyllë kryesore për një qeverisjeje transparente, duke i mundësuar qytetarëve dhe grupeve të interesit diskutimin, dialogun, monitorimin dhe vlerësimin e punës së pushtetit vendor.

Në vëmendje të këtij studimi është njohja dhe zbatimi në bashkinë Pukë i Ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” që detyrojnë organet e vetëqeverisjes vendore të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.

Legjislati aktual në Shqipëri përcakton detyrimin e bashkive për realizimin e njoftimit dhe konsultimit publik pothuajse për çdo vendimarrje që ato kryejnë. Ndër ligjet kryesore që sanksionojnë detyrimin për angazhimin qytetar në vendimmarrjen lokale, më të rëndësishmit janë:

- Ligji Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”
- Ligji Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”
- Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Ligji Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- Ligji Nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”

Duke iu referuar Ligjit Nr.139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore, bashkia si organ ekzekutiv dhe Këshilli Bashkiak si organ përfaqësues kanë detyrimin të sigurojnë transparencën e veprimtarive⁸ të tyre në procesin e vendimmarrjes.

Angazhimi i komunitetit në qeverisjen lokale, ndër të tjera, mundësohet përmes konsultimeve publike, duke sjellë në vëmendje përgjegjësitë e organeve vendore të njohin dhe zbatojnë në praktikë detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. Ky ligj rregullon marrëdhëniet për realizimin e procesit të konsultimit publik, në vendimmarrjet që l përkasin hartimit të projektakteve, të tilla si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politika me interes të lartë publik.

⁸ Neni 16 dhe neni 18 i ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

6. Përshkrimi i strukturës së qeverisjes lokale në bashkinë Pukë:

Informacion i përgjithshëm: Bashkia Pukë përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Pukë, Qelez, Luf - Qerret, Gjegjan dhe Rrapë. Bashkia ka nën administrimin qytetin e Pukës dhe fshatrat si më poshtë.⁹

Emri i Njësisë	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Pukë	Qyteti Pukë, Fshatrat; Pukë, Lajthizë
Gjegjan	Fshatrat; Dom, Gjegjan, Gojan i Vogël, Rras, Kuzhnen, Gojan i Madh, Shkozë, Kimëz, Kalivare, Mesul
Rrapë	Fshatrat; Breg, Rrapë, Kabash, Buhot, Bicaj, Blinisht, Lumzi, Meçe
Qelëz	Fshatrat; Qelëz, Bushat, Dushnezë, Midhë, Buzhalë, Dedaj, Levrushk, Ukth, Qerret i Vogël
Qerret	Fshatrat; Qerret, Luf, Dush, Karmë, Kçirë, Luf-Plan, Korthpulë, Kaftall, Tejkodër, Gomsiqe, Vrith, Plet.

Bashkia Pukë është një nga 61 bashkitë e Republikës së Shqipërisë. Bashkia e Pukës ka një popullsi rreth 16,836 banorë sipas regjistrit civil dhe një sipërfaqe totale prej 505 kilometra katrorë. Bashkia e Pukës shtrihet nga Komani ku Liqeni ndan Pukën me Shkodrën, deri në SH&SH që ndan territorin me Fusharrëzin, Lezhen, Vaun e Dejes. Në këtë territor shtrihen qendra të rëndësishme të turizmit: si zona e mbrojtur e Munellës. Mali I Tërbunit, Gryka e Komanit dhe Lumi I Shales, kisha e Dalmacisë, etj.

Numri i bizneseve aktive për vitin 2023 është 105 persona Fizik (75 % e tyre mund të quhen biznese familjare ose vetpunësimi) dhe 43 Juridik, ndërsa numri i punonjësve të bashkisë për

⁹ Burimi: Porta Vendore

njëjtin 2024 është 360 persona nga të cilët 72 janë pjesë e administratës së bashkisë dhe 298 janë të punësuar në njësitë shpenzuese.

Në bashkinë e Pukës aktualisht janë duke u përgatitur disa projekte të rëndësishëm në infrastrukturë dhe që janë në studim projekte të tjera zhvillimi në lidhje me zhvillimin e saj të ardhshëm sidomos në fushën e turizmit dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore. Pavarësisht se cilësia e rrugëve në vitet e fundit është përmirësuar ndjeshëm akoma ka probleme për rrugët rurale në fshatra dhe sistemimin e territorit në lagjet e qytetit. Sfidë mbetet gjithashtu menaxhimi i mbetjeve urbane vecanerisht në periudhën e sezonit të verës ku për shkak të shtimit të vizitoreve shtohet edhe konsumi dhe nevoja për rritje të shërbimeve.

Këshilli Bashkiak Pukë, përbëhet nga 15 anëtarë që vijnë nga disa forca të ndryshme politike. Të ndarë sipas gjinisë janë 11 M/ 4 F anëtarët e KB kanë ngritur 8 komisione, ndërsa një komision u krijua për Rininë dhe Barazinë gjinore. Si organ përfaqësues aktualisht rregullon marrëdhëniet dhe ndërveprimin e tij me publikun përmes rregulloreve të brendshme të miratuara si më poshtë:

- *Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Pukë.*
- *Rregullore për Marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me Publikun dhe Mediat.*

Së fundmi me nxitje nga jashtë siç është Bashki të forta, është aprovuar nga KB “*Miratimi I Rishikimit të Programit të Transparencës të Bashkisë Pukë*”, një dokument i rëndësishëm që pritet të përmirësojë ndërveprimin me qytetarët, më specifiku, bazuar në detyrimet ligjore që rrjedhin nga Ligji Nr.146/2014. Fusha e gjashtë e tij parashikon informacionin dhe procedurat e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje, ku përfshihen informacione në lidhje me procesin, procedurat, kuadrin rregullator vendor, listën e akteve vendore që i nënshtrohen konsultimit publik dhe nismat qytetare. Ky program parashikon bashkëpunimin e Këshillit Bashkiak dhe bashkisë Pukë.

Bashkia Pukë si organ ekzekutiv përmes kryetarit ka miratuar urdhëra të brendshëm që lidhen me aspektet procedurale dhe zbatimin të Ligji Nr. 146/2014. Në rregulloren e brendshme të funksionimit dhe organizimit të administratës, miratuar më 2017 nuk ka detyra specifike për koordinatorin e njoftimit dhe konsultimit publik dhe drejtori specifike që mbulon këtë pozicion. Gjithësesi, marrëdhëniet me publikun (qytetarët) të bashkisë Pukë realizohen nëpërmjet Drejtorisë së Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun duke përdorur me se shumti komunikimet online.

Kryetari I bashkisë dhe stafi i bashkisë Pukë, pas miratimit të “Programit Model të Rishikimit të Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore”, është duke përgatitur grupin e punës dhe caktimin e personave përgjegjës nga stafi I bashkisë me qëllim plotësimin e fushave të përcaktuara në këtë program, duke i dhënë rëndësi të vecantë fushës 6 – atë të pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje. Aktualisht programi i rishikuar I transparencës do të koordinohet dhe mbikëqyret nga një nën/kryetar i bashkisë Pukë, duke theksuar rëndësinë e komunikimit me publikun dhe transparencën në vendimmarrjen e institucionit të bashkisë.

Më poshtë listohen disa prej proceduarve dhe proceseve ku bashkia e Pukës dhe KB janë të detyruar të kryejnë njoftim dhe konsultim publik për qytetarët dhe grupet e interesit:

- **Konsultimeve me publikun për buxhetin vjetor, sipas ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”**
- **Këshilli bashkiak zhvillon seanca të konsultimeve me publikun për projekt dokumentin e parë të programit buxhetor afatmesëm (brenda muajit Maj) dhe të projekt-buxhetit vjetor.**
- **Këshilli Bashkiak shqyrton dhe miraton projektin e parë deri te version final të programit buxhetor afatmesëm, afati nga 30 qershor – 30 shtator. Kryetari i NJQV-së dhe anëtarët e Grupit të Menaxhimit Strategjik realizojnë dëgjesa publike nga 1 shtatori – 30 nëntor, duke ftuar dhe Këshillin Bashkiak për projekt-buxhetin vjetor të vitit pasardhës.**
- **Plani i përgjithshëm vendor dhe gjithë ndryshimet që lidhen me të, proces që bëhet me konsultim publik.**
- **Ndryshim destinacioni I pronës publike, që është në inventarin e pronave të bashkisë. Vendimarrja I takon vetëm Këshillit Bashkiak, ndërsa procesi realizohet nga të dyja palët së bashku ose në mënyrë të pavarur.**
- **Dokumente të brendshme, rregullore, plane veprimi, strategji të prodhuara nga administrata e bashkisë ose nga vetë këshilli bashkiak, para miratimit duhet ti nënshtrohen procedurës së konsultimit publik.**
- **Vendimarrje që ndikojnë direkt në jetën e qytetarëve dhe kanë efekte financiare, psh rrugë publike, parqe eolike, landfill, ku bashkia vendos vetë një pjesë të fondeve**

7. Historiku I procesit të njoftimit dhe konsultimit publik në bashkinë Pukë

Historiku i procesit të njoftimit dhe konsultimit publik në Bashkinë e Pukës ka kaluar nëpër disa faza zhvillimi përgjatë viteve të fundit duke marrë parasysh edhe risitë e kohës dhe ndryshimet e ardhura falë ndryshimeve në kontekstin politik dhe vullnetin e administratës publike. Përfshirja e qeverisjes si dhe ajo e komunitetit të qytetit të Pukës ka pësuar ndryshime përsa i përket mënyrës së njoftimit, dhe rolit të secilit prej aktorëve të përfshirë në proces.

- Në fazat e para te procesit të njoftimit konsultimit si dhe vetë konsultimi publik është bërë në mënyrë më joformale. Pjesa më e madhe e takimeve të kryera kanë pasur karakter bisedor.
- Së fundmi, duke marrë parasysh ndryshimet në administratë, takimet kanë marrë karakter më formal dhe është rritur llogaridhënia dhe transparenca e procesit. Gjithashtu është shtuar pjesëmarrja e komunitetit në dëgjesa apo konsultime publike dhe janë marrë parasysh kërkesat e tyre.
- Tashmë Bashkia Pukë ka një website të rrëgjullt për marrjen e informacionit në të gjithë sektorët e nevojshëm dhe mënyra e të komunikuarit më komunitetin është lehtësuar.
- Të gjithë njoftimet publikohen dhe ruhen në faqen e internetit të Bashkisë Pukë dhe gjithashtu edhe në faqet zyrtare te rrjeteve sociale.

Bazuar në detyrimet që rrjedhin

nga ligji nr.146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, ligji nr. 119/20214 "Për të Drejtën e Informimit", si dhe ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, pjesëmarrja në vendimarrje merr një rol të rëndësishëm, duke mundësuar një lidhje më të ngushtë midis pushtetit dhe qytetarëve duke rritur përgjegjshmërinë për të ofruar shërbime më të mira dhe më efikase. Në këtë kontekst, pjesëmarrja e qytetarëve në procese të ndryshme vendimarrëse konsiderohet shumë e rëndësishme.

Në shumë raste janë hasur reagime nga qytetarët, të cilët vinin re që kishte dukshëm mungesë informacioni si dhe dokumentacioni mbi projekt-aktin dhe gjithashtu kishte ankesa që

Programi i transparencës është lehtësisht i aksesueshëm dhe është vënë në dispozicion të publikut nëpërmjet faqes zyrtare në internet. Qëllimi i këtij programi është të përmbushë detyrimin ligjor për informimin e publikut dhe të sigurojë transparencë në administratën e bashkisë dhe këshillit bashkiak, lidhur me procedurat dhe miratimin e akteve të ndryshme.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale i ka dërguar organeve të QV, një program model rishikimi transparence të miratuar prej tij me urdhërin Nr.211, datë 10.09.2018. Ndërkohë Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) me shkresën Nr. 518 me datë 19.09.2018. ka vënë në dijeni Bashkinë Pukë se ky projekt është i miratuar dhe se duke filluar nga data 1 Janar 2019 të bëhet i detyrueshëm për tu zbatuar.

Nën asistencën e KDIMDP dhe AMVV-së është miratuar me VKB Nr.129 datë 06.12.2018, Programi i Transparencës, që prej miratimit të tij në dhjetor të 2018 e deri në maj të 2024, programi është zbatuar pjesërisht nga bashkia Pukë dhe KB.

Njëkohësisht, Këshilli Bashkiak ka organizuar herë pas here sondazhe online për të identifikuar prioritetet e qytetarëve lidhur me projektet e buxhetit të PBA-së dhe ka marrë pjesë në dëgjuesat e buxhetimit që ka organizuar së bashku me bashkinë dhe publikun gjatë viteve të kaluara. Megjithëse ekziston një rregullore e miratuar dhe procedura të qarta, vërehet se iniciativat e ndërmarra nga anëtarët e Këshillit kanë qenë modeste, dhe shpesh shumica e tyre nuk janë të vetëdijshëm për rolin dhe kompetencat që u jep legjislacioni vendor.

Këshilli Bashkiak shpërndan njoftimet për mbledhjet kryesisht në mediat sociale dhe, në disa raste, edhe në faqen zyrtare të bashkisë. Çdo njoftim përfshin informacion të detajuar mbi datën, vendin, orën dhe rendin e ditës, ndërsa aktet e miratuara shpallen në faqen zyrtare të internetit dhe në stendën e njoftimeve publike të Bashkisë Pukë. Sipas monitorimeve të faqes së Këshillit, regjistrat elektronikë janë publikuar dhe ndahen në:

- Organizimi dhe funksioni i Bashkisë [Organizimi dhe funksionimi i Bashkise. | bashkia puke, faqja zyrtare](#)
- Rregjistri publik për transparencën e mbledhjeve [Regjistri publik për transparencën e mbledhjeve të këshillit | bashkia puke, faqja zyrtare](#)
- Rregjistri i projekt-akteve për konsultimin publik [Regjistri i projekt akteve per konsultim publik | bashkia puke, faqja zyrtare](#)
- Kërkesa për informim [Kërkesa për informim | bashkia puke, faqja zyrtare](#)

- Rregjistri i ankesë-
kërkesave [Regjistri Ankesë/Kerkese](#) | [bashkia puke, faqja zyrtare](#)

Një pjesë e anëtarëve të Këshillit Bashkiak janë aktivë dhe marrin pjesë në dëgjesat publike të organizuara kryesisht nga bashkia, që është një aspekt pozitiv. Megjithatë, është e nevojshme që ata të njohin dhe të zbatojnë rregulloret që vetë kanë miratuar, duke marrë një rol udhëheqës në proceset që ligji kërkon të konsultohen. Gjithashtu, ka nevojë për plotësimin e të dhënave në regjistrin e mbledhjeve dhe takimeve publike të Këshillit.

Megjithatë, lidhur me këtë rekomandim, anëtarët e Këshillit Bashkiak shpesh ankohen se projekt-aktet që duhen konsultuar arrijnë në momentet e fundit, vetëm pak para mbledhjes së ardhshme, dhe pa dokumentacionin e plotë shoqëruar. Kjo i pengon ata në organizimin e dëgjesave publike.

8. Vlerësim i efektivitetit dhe transparencës së procesit të konsultimit public

Për të vlerësuar efektivitetin e transparencës së procesit të konsultimit publik, rrjeti POP bazuar në metodologjinë e studimit hartoi dhe shpërndau: (i) Kërkesë për informacion drejtuar bashkisë; (ii) realizoi intervista të thelluara me staf të bashkisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkia; (iii) monitoroi publikimet në faqen e internetit të bashkisë dhe raporte alternative të prodhuara nga palë të treta; (iv) asistoi nga afër konsultime publike nga nxjerrja e projekt-aktit deri në miratimin përfundimtar të tij.

Rrjeti POP dhe LRD përgatitën një kërkesë për informacion¹⁰, ku përgjigja është dhënë brenda afateve ligjore me email¹¹ dhe dokumentacion shkresor¹². Në lidhje me informacionin mbi “Zbatimin e proceseve të ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik në Bashkinë Pukë, për periudhën Shtator 2023- Maj 2024” Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik për Bashkinë Pukë bazuar në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjin nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, vendosi në dispozicion informacionin që është pasqyuar në tabelën më poshtë. Gjithashtu në tabelën përmbledhëse gjeni informacion të thelluar dhe mbi përgjigjet e bashkisë dhe një vlerësim shprehet me i/e realizuar plotësisht, pjesërisht, aspak. Komente rreth gjetjeve nga monitorimi janë në dispozicion të lexuesve të këtij raporti, me qëllim për të vlerësuar efektivitetin e procedurave që zbatohen nga bashkia Pukë.

Kërkesa për informacion	Përgjigjet e bashkisë Pukë	Komente / Mjetet e verifikimit	Vlerësimi
1. Emri, kontaktet e Koordinatorit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe kopje të vendimit të emërimit të tij.	<i>Koordinatorë për njoftimet dhe konsultimet publike janë z. Sokol Gjoni dhe z. Erin Neziri, të cilët e mbulojnë këtë detyrë pa urdhër specifik, pasi me strukturën e re akoma nuk është zbardhur urdhëri sipas pozicioneve të</i>	https://bashkiapuke.gov.al/koordinatori-infot-e-kerkuara-dhe-sherbimet-e-ofruara/	I realizuar

¹⁰ Kërkesë për Informim - “Zbatimi i proceseve të ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik në Bashkinë Pukë, për periudhën shtator 2023-maj 2024” protokolluar me nr.1264 në datën 31.05.2024

¹¹ Kthimi i përgjigjes nga Koordinatorin e Konsultimit Publik bashkia Pukë, me email më datë 25 Qershor 2024

¹² Kthim përgjigjeje, nr. Prot 1264/1, më datë 28.06.2024 – dokumentacion shoqëruar shkresor, bashkia Pukë.

	<i>reja, ku përfshihet dhe koordinatori për njoftimet publike.</i> Email: info@bashkiapuke.gov.al		
2. Linkun e regjistrimit elektronik ku janë publikuar projektaktet, e njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 6, pika 1, gërma a) e ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;	Në përgjigjen zyrtare të bashkisë është dërguar linku https://bashkiapuke.gov.al/konsultimet-publike/	Informacioni nuk është i përditësuar, edhe pse bashkia ka realizuar konsultime publike për çështje të ndryshme kopje të të cilave na I ka nisur bashkëngjitur me shkresën zyrtare të përgjigjes, vërejmë se në faqen e internetit në rubriken konsultime publike nuk ka informacion të përditësuar.	E porealizuar
3. Kopje të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, te publikuara në programin e transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”	Nuk kanë kopje të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes.	Bashkia duhet të përdorë hapësirën dhe komunikimin digjital përmes faqes zyrtare ku tashmë secili I interesuar për për çdo lloj informacioni I referohet faqes dhe informacionit online.	E porealizuar
4. Mënyrat e njoftimit gjate procesit të konsultimit publik që kryen bashkia Pukë	Nga përgjigjet zyrtare të bashkisë Pukë, përdoret zakonisht njoftimi me: <ul style="list-style-type: none"> - Me postë elektronike, - me lajmërim publik, duke e afishuar në ambiente publike, - Njoftime me takime fizike 	Nga praktika, është vënë re se njoftimet publikohen në faqen e internetit të bashkisë dhe në mediat sociale të bashkisë dhe KB.	I realizuar plotësisht
5. Mënyrat e marrjes së komenteve dhe rekomandimeve gjatë procesit të konsultimit publik	Sipas bashkisë Pukë, mënyrat e marrjes së komenteve janë kryesisht: <ul style="list-style-type: none"> - me postë elektronike; - në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike. 	Nga verifikimi dhe dokumentimi I dëgjesave që ka realizuar bashkia Pukë në periudhën e monitorimit, komente janë marrë me email, Dëgjesat publike transmetohen live ne mediat lokale, kryesisht ato të rrjeteve sociale dhe I bashkëlidhen dokumentacionit shoqërues të dëgjesave që publikohet dhe në faqen e internetit të KB dhe bashkisë.	I realizuar plotësisht
6. A ka patur raste kur është zgjatur ose përsëritur faza e konsultimit?	Sipas përgjigjes së bashkisë nuk ka patur raste të përsëritjes së fazës së konsultimit publik.	Nga monitorimi i dëgjesave publike ka patur raste ku konsultimi është zgjatur për shkak të kontestimit nga ana e qytetarëve ose grupeve të interes për çështje të veçanta, për këtë qëllim janë realizuar takime të tjera dhe rekomandimet janë marrë parasysh, rastet kanë qenë kryesisht për lejet e përdorimit të hapsirave ku pretendimet për	Pjesërisht I realizuar

		pronësinë kanë vonuar dhe cënuar fazat e konsultimit publik	
7. Nese Po ju lutem na dërgoni arsyet si dhe kopje të aktit për të cilin është zgatur ose përsëritur faza e konsultimit	Nuk ka përgjigje nga bashkia Pukë.	Verifikohet se në rastin e dëgjesës për dhëjen në përdorim të fondit pyjor për zhvillime të parqeve eolike, për zhvillim të resorteve turistike apo studime të ndryshme për shfrytëzimin e hapsirave e burimeve natyrore shpesh është zgatur faza e konsultimit me qëllim marrjen e rekomandimeve dhe rishikimin e kushteve të përdorimit.	Pjesërisht I realizuar
8. Kopje të njoftimit për takime publike	Bashkëlidhur shkresës bashkia ka dërguar kopje të njoftimeve për takimet publike. -“Njoftim mbi Dëgjesen Publike me banorët e fshatit Qerret i Madh, njësia administrative Luf – Qerret, e realizuar me datë 18.04.2024” - Dëgjesen publike për BPA-ne 2024 - 2026	Duke shqyrtuar dokumentacionin e vendosur në dispozicion të kërkesës për informim, vihet re se janë përgatitur herë pas here UB të kryetarit të bashkisë, në disa raste njoftime në faqen e internetit dhe mediat sociale. Ndërsa KB zakonisht ndan njoftimet vetëm ne mediat sociale dhe faqen e internetit. Mbetet për tu unifikuar forma dhe procedura e njoftimit që publikohet.	Pjesërisht I realizuar
9. Kopje të Procesverbaleve të takimeve publike të zhvilluara gjatë periudhës Shtator 2023 – Maj 2024	-Nuk na u vu në dispozicion të shkresës ndonjë <i>Kopje e procesverbaleve pasi na u përgjigjen se dokumentacionet janë mbajtur nga drejtoritë përkatëse, të cilat kanë realizuar dëgjesat publike.</i>	Në faqen e webit të bashkisë nuk janë publikuar procesverbalet e dëgjesave publike të realizuara nga bashkia.	E përealizuar
10. Kopje të Projektakteve të miratuara gjatë periudhës Shtator 2023 – Maj 2024 shoqëruar me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”	Nuk ka	Nga përgjigjet nuk ka analizë të projektakteve të realizuara me konsultim publik, mungon informacioni që shoqërohet me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”	E përealizuar
11. Kopje te Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes per vitin 2023	Bashkëlidhur shkresës, është vënë në dispozicion linku I raportit për transparencën.	Vërehet mungesë e informacionit të përditësuar	Pjesërisht e realizuar

	https://bashkiapuke.gov.al/transparenca-dhe-llogaridhenia-ekonomiko-financiare/		
12. Nëse ka patur ankesa në lidhje me procesin për njoftim dhe konsultim publik. Nëse PO ju lutem na dërgoni kopje të ankesave.	Në institucion nuk ka të depozituar ankesa në lidhje me procesin për njoftimin dhe konklutimin publik	Nga qytetarët apo grupet e interesit nuk ka ankesa për procesin e realizuar në periudhën shtator 2023– maj 2024.	I realizuar
Aneke të tjera informative në lidhje me aktivitetin e bashkisë,	<p>Plani I Integritetit është realizuar nga STAR 2 me IDM, bashkia ka bërë adaptimin e informacionit https://bashkiapuke.gov.al/ep-content/uploads/2024/07/PI_Bashkia-Puke-1.pdf</p> <p>Raport Monitorimi i realizimit të zbatimit të Planit të Integritetit 2023 https://bashkiapuke.gov.al/ep-content/uploads/2024/07/Bashkia-Puke.pdf</p> <p>Janë 7 kërkesa online në regjistrin e Ankesë – Kërkesë https://bashkiapuke.gov.al/regjistri-ankese-kerkese/</p>	Bashkia duhet të përdorë më shumë hapësirat informative dhe të përditësojë shumë nga informacionet që disponon në faqen zyrtare.	

8.1 Gjetje nga intervistat e realizuara me staf të bashkisë Pukë

Anketimi me përfaqësues të Bashkisë Pukë përfshiu 5 zyrtarë, që janë drejtues nga drejtoritë dhe sektorët e ndryshëm të Bashkisë Pukë, që janë të angazhuar në procese që lidhen drejtëpërdrejtë me njoftimin dhe konsultimin publik me qytetarët.

Anketimi ka për qëllim të evidentojë dhe të analizojë format dhe instrumentet që përdor Bashkia për të afruar qytetarët më pranë vendimmarrjes. Intervistat shërbyen dhe për të shkëmbyer ide dhe sygjerime për përmirësimin e punës në lidhje me procesin e njoftimit dhe konsultimit publik. Anketa përmbante 27 pyetje të cilave administrata e bashkisë iu përgjigj thujse njëjtë

Në përputhje me detyrimet e përcaktuara në Ligjin 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", të intervistuarit u pyetën nëse bashkia e tyre ka standardizuar procedurat administrative për njoftimin dhe konsultimin publik (rregullore të brendshme, urdhra, forma standarde, verifikim). Të gjithë ata konfirmuan se ekzistojnë procedura, duke përmendur disa elemente të saj, si urdhërat e brendshëm të Këshillit për njoftimet e dëgjësive publike dhe format standarde të konsultimit. Megjithatë, ata theksuan se nuk ka një rregullore ose udhëzim që të rregullojë procesin e njoftimit dhe konsultimit, në përputhje me të gjitha nenet e ligjit.

Të intervistuarit renditën disa prej projektakteve që janë realizuar në konsultim me qytetarët për periudhën shtator 2023-maj 2024, duke evidentuar: Dëgjesat e Buxhetimit me Pjesëmarrje në 4 Njësitë Administrative për PBA 2024-2026 dhe buxhetin vjetor të 2024; dëgjesat për Takasat dhe Tarifave vendore 2024-2025; për Tarifen e Ujësjetllës Kanalizime, dëgjesa për dhënje në përdorim të të siperfaqeve kryesisht pyjore për zhvillimin e veprimtarive turistike, etj.

Bazuar në përvojën e akumuluar gjatë viteve, të intervistuarit theksuan se procesi i Buxhetimit me Pjesëmarrje është një nga mekanizmat më efektivë për konsultimin e publikut. Koha është specifikuar se ka më shumë se 3 vjet që po zhvillohen proceset e buxhetimit me pjesëmarrje, bashkia dhe stafi i saj kanë zbatuar procedurën e njoftimit dhe konsultimit publik, duke shqyrtuar projekte të ndryshme. Ata theksojnë se ky proces është përmirësuar vazhdimisht falë përvojës së grumbulluar gjatë viteve. Sa i përket iniciativës për njoftimin dhe konsultimin publik, të intervistuarit theksuan se kryesisht ka qenë kryetari i bashkisë që e ka iniciuar. Në disa raste, kërkesat kanë ardhur nga organizatat e shoqërisë civile dhe projekte donatorësh, të cilat, në bashkëpunim me bashkinë, kanë organizuar njoftimin dhe konsultimin publik.

Një rol të rëndësishëm për angazhimin e publikut në vendimmarrje ka programi i transparencës, që bashkia ka obligim ta miratojë dhe të ofrojë informacion dhe procedura që mbështesin pjesëmarrjen e qytetarëve në këtë proces. Të gjithë të anketuarit e dinë se ka vendime dhe urdhëra të brendshme të miratuara nga Kryetari i bashkisë apo këshilli i bashkisë për programin e transparencës. Ndërsa shumica e të anketuarve shprehen se mungon informacioni cilësor në web faqen e bashkisë edhe për shkak të mungesës së kapaciteteve në bashki. Gjithashtu, një detyrë e rëndësishme mbetet për zhvilluesin e faqes së bashkisë, që materialet të jenë të kuptueshme dhe të përditësohen rregullisht.


Në bashkinë Pukë ka një Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, që është emëruar në 2023. Bazuar në intervistat e realizuara, u shprehen se forma më e përkthyer dhe më e përfshirë e dëgjesave publike, njoftimi dhe konsultimi publik kryhet përmes takimeve me përfaqësues të NJAV, grupeve të interesit kryesisht bizneset lokale. Rekomandimet dhe komentet e qytetarëve përfshihen në raporte, por vendimmarrja për ndryshimet i takon drejtorisë ose ekipit përgjegjës për miratimin e këtij projekt-akti. Nën këtë perspektivë, roli i koordinorit nuk është dinamik dhe shpesh ai nuk ka autoritetin për të udhëhequr ose për të vepruar në mënyrë të pavarur. Ai gjithmonë vepron si mbështetje për sektorin ose drejtorinë që organizon dëgjesën.

Zakonisht, drejtoritë që përfshihen në procesin e konsultimit publik janë:

- Drejtoria e Menaxhimit Financiar (për procesin e PBA dhe BP)
- Drejtoria Juridike, Aseteve dhe Pronave
- Drejtoria e Informacionit
- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore
- Kabineti i Kryetarit të Bashkisë (Drejtori i Kabinetit dhe këshilltarët)
- Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve
- Sektori i Shërbimeve

Po ashtu, përfshihet çdo drejtori tjetër që ka lidhje me projekt-aktin që konsultohet.

Të gjithë të intervistuarit thanë se bashkia përdorte njoftimet përmes mediave sociale, mediave lokale dhe ato individuale si mënyra kryesore për të informuar dhe përfshirë qytetarët. Në të njëjtën kohë, njoftimet bëhen edhe me E-mail apo gojarisht nga administratorët e kryepleqtë në Nj.A. Megjithatë, regjistri elektronik dhe botimet në gazetatat lokale nuk përdoren shumë si forma e njoftimit për këtë proces. Transmetimi live i dëgjësave publike dhe mbledhjeve të këshillit të bashkisë, në mediat lokale dhe sociale ka rritur informimin e qytetarëve për çështje të tyre, por pjesëmarrja qytetare mbetet e ulët.



Të gjithë të intervistuarit shprehen se respektohen afatet e informimit për dëgjësas publike, përcaktohet dhe qytetarët e dinë ku duhet të dërgojnë rekomandimet e tyre, të dhënat e kordinatorit për njoftimin publik vendosen të njoftimi i vendosur paraprakisht, ndërsa publikohet njoftimi, ftesa, vendi dhe koha e organizimit të konsultimit publik në rrjetet sociale, në këndin e njoftimit publik, me komunikime verbale në komunitet etj.

Bashkia nuk ka një regjister apo plan vendor për procesin e vendimmarrjes me pjesmarrje apo dëgjësas publike.

Gjatë takimeve dhe konsultimeve publike mbahen procesverbalet e takimeve dhe arkivohen bashkë me dosjen e përgatitur për secilin rast.

Koordinatori për njoftimin publik është përgjegjës për përditësimin e regjistrit të dëgjësave publike. Megjithatë, ky regjistër është në formatin hard-copy dhe nuk është i disponueshëm online. Raportet e dëgjësave publike ngarkohen online pas realizimit të procesit të konsultimit ose dëgjësës publike. Të gjithë të intervistuarit thanë se përgjegjësitë për mbajtjen dhe përditësimin e këtij regjistri janë të Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Sipas të dhënave nga procesverbalet e dëgjësave për konsultimin publik, rreth 200 persona kanë marrë pjesë në dëgjësas publike të zhvilluara nga shtatori 2023 deri në maj 2024. Nuk është mbajtur një listë e pjesmarrjes ato mund të vlerësohen vetëm në nga materialet e prezantuara përmes faqeve dhe rrjeteve sociale. Në këto takime morën pjesë gjithashtu grupe interesi dhe LRD një nga organizatat lokale të vetme që merr pjesë në procese të ndryshme të konsultimit publik, në përgjithësi pjesmarrësit kanë njohuri të mira mbi ligjin dhe ndikojnë në grupet që përfaqësojnë për çështje të ndryshme të vendimmarrjes.

Në bashkinë Pukë, nuk ekziston një strukturë e dedikuar për monitorimin dhe vlerësimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik. Zbatimi i ligjit zakonisht shqyrtohet kur organet e kontrollit, si Prefektura, KLSH ose KDIMDP, kërkojnë informacione të tjera ose vlerësojnë proceset e konsultimit publik.

Procesi i zbatimit të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, sipas të intervistuarve, përballet me shumë vështirësi dhe sfida, kryesisht për shkak të mungesës së infrastrukturës së duhur, si dhe kapaciteteve dhe përvojës të pamjaftueshme nga stafi i bashkisë.

Ata theksojnë se ekziston indiferencë, mungesë informacioni, ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrjeje të ulët nga qytetarët në takime, ndërsa bashkia has vështirësi në përfshirjen e grupeve të ndryshme të interesit. Megjithatë, ata besojnë se kanë ofruar mjete alternative për të rritur angazhimin qytetar, për shkak të rritjes së ndërgjegjësimit dhe informimit përmes formave të reja, siç janë publikimi online i dëgjësive publike dhe rritja e numrit të dëgjësive për projekte të caktuara. Referuar grupeve të banorëve të cilët jetojnë në zona të thella rurale ku mungon infrastruktura komunikuese përmes rrjeteve sociale bashkia ka përdorur metodat e informimit përmes takimeve, njoftimeve individuale, bashkëpunimit me kryetarët e fshatrave etj.

Rekomandimet për përmirësimin e këtij procesi fokusohen kryesisht në ofrimin e asistencës teknike, rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, si dhe informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve, me qëllim që të forcohet ndërvëprimi dhe bashkëpunimi me stafin e bashkisë.

8.2 Gjetje nga intervistat e zhvilluara me anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Duke njohur dhe vlerësuar dhe rolin e kontributin e organit legjislativ (KB) në qeverisjen vendore dhe proceset pjesëmarrëse të qytetarëve, një pyetësor u përgatit dhe u shpërnda për 5 përfaqësues të KB, duke përfshirë sekretarin, kryetarin e KB, përfaqësues nga komisioni juridik, I financave, komisioni i peticioneve. (Aneks – formati I pyetësorit me Këshilltarët Bashkiakë)

Të pyetur mbi opinionin e tyre si këshilltarë vendor mbi perceptimin që ata kanë për rëndësinë e pjesëmarrjes së publikut dhe grupeve të interesit, në procesin e hartimit dhe vendimarrjes, të gjithë të intervistuarit shprehën se ata e konsiderojnë shumë të rëndësishëm. Përveç se është detyrim ligjor, I shprehur dhe në rregulloret e brendshme të KB, të intervistuarit shprehën se ata kanë rritur ndjeshëm informimin ndaj qytetarëve, së pari duke trasmetuar mbledhjet e KB live, por është rritur dhe ndërvëprimi me publikun, përmes publikimit e shpërndarjes në mediat sociale dhe në faqen web të këshillit të cdo njoftimi për dëgjësë publike.

Gjithashtu edhe këshillimi me bashkinë në perceptimin e të intervistuarve ka rëndësi shumë të madhe, sepse prej takimeve, këshilltarët marrin informacion të nevojshëm për të ndërvëpruar me qytetarët dhe për të marrë rekomandime e komente që janë sa më afër nevojave të komunitetit. Ata tregojnë se kanë qënë prezent në mjaft dëgjësja të organizuara nga bashkia dhe KB.

Përsa i përket përfshirjes së qytetarëve në vendimarrje ata e konsiderojnë të rëndësishme, por jo gjithmonë sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve. Kjo për shkak se ata nuk mund ti detyrojnë qytetarët të jenë prezent në takimet që realizojnë, por theksojnë se ata përpiqen që pas komunikimeve me qytetarët, ti ngrejnjë çështjet për diskutim në rendin e ditës së mbledhjes së KB, tek “të ndryshme”.

Anëtarët e Këshillit shprehen se e njohin bazën ligjore, bazuar dhe në rregulloret që janë aprovuar nga KB. Ata mundohen të aplikojnë procedurat që parashikojnë rregulloret, por disa prej procedurave, në mjaft raste nuk përputhen me situatën në realitet. Këshilli I dalë nga zgjedhjet vendore të 2023 është në masen 2/3 përfaqësues për herë të parë në këshill dhe nuk janë shumë të informuar rreth funksioneve dhe detyrave si Këshilltarë. Disa trajnime për rritje të kapaciteteve të tyre kanë organizuar përmes projektit Bashki të Forta, raste në të cilat vërehet mungese dhe neglizhencë e tyre për të marrë pjesë. Të anketuarit kanë sjellë në vëmendje se duhet një punë më e organizuar e administratës së Bashkisë për sa ju takon kohës dhe cilësisë së përgatitjes së materialeve që do shqyrtohen gjatë mbledhjes së këshillit bashkiak, duke vënë dhe theksin se përveç gjërave rutinë të përmuajshme nuk ka pasur ndonjë vendimarrje specifike për ndonjë rast për tu shënuar siç mund të jenë mbështetje specifike për familjet në nevojë apo strehimin social, për mbështetje ndaj grave kryefamiljare, për grupet në nevojë, nuk është miratuar ndonjë plan veprimi apo projekt për nxitjen e punësimit të të rinjëve dhe grave etj.

Këshilltarët e dinë dhe kanë përmendur se janë dy rregullore kryesore që rregullojnë veprimtarinë e KB mbi njoftimin dhe konsultimin publik. Ato janë (1) *Rregullorja për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Pukë* dhe (2) *Rregullore për Marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me Publikun dhe Mediat. Gjithashtu dhe Programi i Rishikuar i Transparencës.*

Mjetet që po përdor KB për njoftimin dhe konsultimin publik, rezultojnë të jenë përdorimi i rrjeteve sociale në masen (85%). Të tjerat vijojnë me lajmërimet publik të afishuar në ambjentet e bashkisë (60%) dhe lajmërimet në grupe E-mail dhe përmes telefonit. Nga përgjigjet e të intervistuarve vërehet se lajmërimi përmes regjistrat elektronik realizohet në faqen e internetit të KB, kryesisht kur procesi realizohet për disa ditë me rradhë.

Egziston një mekanizëm monitorimi dhe raportimi për dëgjesat publike që KB realizojnë, kjo bazuar në rregulloret e tyre dhe programin e rishikuar të transparencës. Gjithashtu këshilltarët referojnë se bëhen dhe raporte monitorimi nga rekomandimet që dalin nga ligji ku ata përmendin raportin vjetor që përgatitet nga sekretari i KB dhe në të janë të analizuarat të dhënat që dalin nga procesi i dëgjesave publike. Gjithashtu raporte të ngjashme publikohen edhe në programin e transparencës.

Zakonisht rekomandimet dhe komentet që dalin nga dëgjesat publike përfshihen në projekt vendimet që përfshihen në buxhetin e propozuar nga bashkia e në disa raste trajtohen edhe si pikë e veçantë e mbledhjeve të KB, në hapësirën (të ndryshme).

Të pyetur nëse ka raste të kthimit të projektvendimeve nga KB, nëse nuk është realizuar procedura e njoftimit dhe konsultimit publik, të intervistuarit u shprehën se Po ka patur raste të tilla, I referohen rasteve të marrjes në përdorim të sipërfaqeve të ndryshme për shfrytëzim apo zhvillime të projekteve lokale, ku një ndër kushtet është realizimi i dëgjesave publike me banorët që preken procesi i cili është realizuar formalisht, ata zakonisht gjetjet dhe rekomandimet që dalin nga ky proces mundohen ti ndjekin deri në zbatimin e tyre përfundimtar.

Në lidhje me mekanizmat e pjesëmarrjes dhe konsultimit që këshilli përdor me qytetarët të intervistuarit janë pergjigjur duke theksuar se **format** që përdorin **gjithmonë** janë: *Buxhetime me Pjesëmarrje; faqja e internetit të KB; Mediat sociale, platformat online ose telefonatat; Tjetër – rregjistrat e kërkesave, ankesave si dhe rregjistri i peticioneve.*

Ndër format që përdor **shpesh** janë: *Seancat dëgjimore publike organizuar nga këshilltarët; Takimet në lagje, fshatra, njësi administrative;*

Ndër format që KB përdor **ndonjëherë** janë: *Seanca dëgjimore të Këshillit Bashkiak; Komisionet këshillimore qytetare; Konsultime me ekspertë; Format e përdorura rrallë ose asnjëherë janë: Studimet mbi matjen e kënaqësisë së qytetarëve, pyetësorë online*

Disa nga aktet ku KB dhe bashkia kanë kryer konsultime publike për periudhën Shtator 2023-Maj 2024 që janë të listuar në raportimin e detajuar në sesionet e mëparshme, por mund të përmendim PBA dhe buxheti vjetor; konsultimi i taksave dhe tarifave vendore 2024-2025;

Në lidhje me sistemin e ankesave, të intervistuarit shprehen se nuk ka ankesa të regjistruara nga qytetarët, drejtuar KB. Nuk raportohet që KB të ketë sistem të vlerësimit dhe monitorimit të mekanizmave të konsultimit publik, ndërsa cdo vit hartohet raporti i transparencës së procesve vendimarrëse. Kapacitetet e anëtarëve të KB për procedura të njoftimit dhe konsultimit publik, vlerësohen pozitivisht, ata janë të aftë ti ndër marrin dhe ti zhvillojnë procedurat e parashikuara në rregulloret e tyre. Si sfidë ata nënvizojnë faktin se ka mungesa të stafit të trajnuar ose kapacitetet njëzëzore në këtë fushë janë të limituara.

Ata shprehen se nuk është se mungojnë mekanizmat, por angazhimi qytetar është në nivele të ulta dhe kjo përbën një prej shqetësimeve kryesore në dëgjesat publike që organizohen.

9. Përmbledhje e komenteve dhe rekomandimeve të grupeve të interesit e qytetarëve nga konsultimi public

9.1 Intervistat e thelluara me grupet e interesit

Ekipi i projektit ka ndërmarrë një hulumtim interesant duke përgatitur dhe shpërndarë dy formate pyetësorësh për të matur nivelin e njohurive dhe angazhimit të qytetarëve në Pukë. Pyetësori i parë u shpernda fizikisht tek anëtarët aktivë në komunitet, përfaqësues të grupeve të interesit, dhe OSHC-ve lokale, ndërsa pyetësori i dyte është shpërndarë online dhe u plotësua nga 104 qytetarë. Në vazhdim, do të jepen të dhëna konkrete lidhur me këtë proces të rëndësishëm.

Anketimi që u zhvillua me 30 përfaqësues të OSHC-ve dhe grupeve të interesit në Pukë, të cilët kishin marrë pjesë në dëgjesat publike, përqendrohej në të drejtat e pjesëmarrjes, format e njoftimit, pjesëmarrjen në konsultime të ndryshme, dhënien e rekomandimeve, bashkëpunimin me bashkinë, dhe sfidat në zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik. Kjo është një pjesë e rëndësishme e procesit për të matur angazhimin dhe perceptimin e qytetarëve në proceset vendimarrëse.

Të gjithë të intervistuarit janë të vetëdijshëm për të drejtën e tyre për të marrë pjesë në proceset e njoftimit dhe konsultimit publik dhe e shfrytëzojnë atë për të ndikuar në vendimmarrjen e institucioneve vendore. Kjo tregon një nivel të lartë të ndërgjegjësimit dhe përfshirjes së tyre në proceset vendimmarrëse lokale. Është e rëndësishme që qytetarët të kenë këtë ndërgjegjësim dhe të pjesëmarrin aktivisht në zhvillimin e komunitetit të tyre.

Bazuar në informacionin e marre, duket se ka një mungesë uniformiteti në mënyrën se si institucionet vendore njoftojnë qytetarët për të marrë pjesë në dëgjesat publike. Në disa raste, bashkia ose Këshilli Bashkiak vendos vetë kush duhet të marrë pjesë, duke mos zbatuar procesin e njoftimit në mënyrë standarde. Kjo mund të sjellë sfida për pjesëmarrjen e barabartë dhe gjithpërfshirëse të qytetarëve në proceset vendimmarrëse lokale. Është e rëndësishme që këto procese të jenë transparente dhe të sigurojnë pjesëmarrjen e të gjithë palëve të interesuara në mënyrë të barabartë.

Të intervistuarit theksuan se gjithmonë kanë marrë pjesë në dëgjesat për projekt-buxhetin e vitit 2024, konsultimet për taksat dhe tarifatat vendore, si dhe në dëgjesa që janë zhvilluar në lagjet e tyre apo që kanë pasur karakter ku vendimet mund të prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë vetë ata. Sa i përket organizatave të shoqërisë civile, ato shprehen se marrin pjesë në konsultime për miratimin e planeve vendore dhe dëgjesa publike me grupe interesi për buxhetimin me pjesëmarrje por jo vetëm.

Qytetarët në përgjithësi marrin pjesë si dëgjues dhe diskutues momental por shprehen se nuk kanë dërguar ndonjëherë rekomandime me shkrim, Gjatë dëgjesave publike, ata diskutojnë shqetësimet e tyre, por shumicën e herëve këto rekomandime nuk reflektohen në dokumentin përfundimtar të projekt-aktit, kjo për shkak se akoma vazhdojnë të jenë shumë probleme të përditshmërisë, siç janë furnizimi me ujë të pijshëm, sistemi i largimit të KUZ, infrastruktura rurale, mungesa e mbështetjes ndaj grupeve në nevojë etj.

Në bazë të përfaqësimit të intervistuarit shprehen ndryshe në opinionet e tyre sa i takon pjesëmarrjes së tyre, sipas interesave grupi i biznesit është më i përfshirë në proceset e ndryshme të konsultimit dhe vendimmarrjes për shkak se me ata lidhet një pjesë e mirë e aktivitetit ekonomik të bashkisë e për këtë arsye edhe vetë bashkia ka qasje tjetër ndaj tyre krahasuar me pjesën tjetër të komunitetit. Bazuar në informacionin që kemi në dispozicion, duket se grupet e interesit të biznesit kanë hasur më shumë sukses dhe rekomandimet e tyre janë marrë parasysh në krahasim me grupet tjera. Është e rëndësishme që të gjitha rekomandimet të trajtohen me seriozitet dhe të marrin peshën e duhur në proceset vendimmarrëse. Është gjithashtu e rëndësishme që të gjithë palët të kenë mundësi të përfaqësojnë pikëpamjet e tyre në mënyrë të barabartë dhe transparente gjatë konsultimeve publike. Bashkia ka rol kyç në këtë proces dhe duhet të sigurojë një mjedis të hapur për pjesëmarrjen dhe ndikimin e të gjithë palëve të interesuara.

Qytetarët e grupet e interesit të intervistuar shprehen se mbi eksperiencën e tyre në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik ku kanë marrë pjesë duke dhënë dhënë komentet e tyre në formë verbale dhe/ose me shkrim, të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike

Në formë verbale në takime është

shprehur se çdo rekomandim mund të dërgohet bashkisë pa sqaruar në mënyre konkrete, afatin prej 20 ditësh për marrjen e komenteve/rekomandimeve dhe shumë pak dinë që duhen dërguar te adresa e koordinatorit të njoftimit dhe konsultimit publik në bashkinë Pukë. Të gjithë të intervistuarit shprehen se nëse duna të dërgojnë një rekomandim apo shqetësim do e nisnin tek bashkia, pastaj vetë bashkia do dijë ku duhet deleguar ankesa/ kërkesa apo çdo komunikim tjetër që qytetarët kanë nevojë ti drejtohen bashkisë.

Koha që grupet e interesit, qytetarët dhe OSHC-të kanë në dispozicion për të marrë pjesë në një konsultim publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij është në disa raste e shkurtër.

Qytetarët shprehen se në përgjithësi rekomandimet e tyre janë marrë parasysh dhe janë reflektuar në projekte apo vendime, po ashtu besojnë se konsultimet publike të realizuara në mënyrë cilësore ë të bazuara në ligj e rregullore do kishin impakt pozitiv në çështje të ndryshme komunitare.

Të anketuarit janë shprehur se kanë pasur në dispozicion projekt – aktin e shqyrtuar gjatë takimeve dhe konsultimeve publike dhe se për padakortësinë që mund të kenë pasur janë shprehur se kanë pasur kohë për të ngritur kundërshtitë dhe në përgjithësi janë dëgjuar, ndërsa për rastet kur nuk janë marrë parasysh shprehen se kanë përdorur forma të ndryshme për ti referuar dhe nëpërmjet komunikimeve dhe përdorimit të rrjeteve sociale, duke mbledhur firma për ta kundërshtuar si dhe me ankeesa në institucionet e tjera.

Në lidhje me sfidat e njohjes dhe zbatimit të ligjit për njoftimin dhe konsultimin, shumica e të intervistuarve theksojnë se qytetarët kanë pak mundësi për të reaguuar, ndërsa bashkia dhe Këshilli Bashkiak nuk e njohin ose zbatojnë ligjin. Nëse nuk krijohet një ndërveprim me qytetarët, ata nuk do të angazhohen dhe nuk do të kontribuojnë në vendimarrjen lokale. Rritja e informimit tek qytetarët vazhdon të jëtë sfida, si dhe bashkia duhet të punojë shumë që proceset e konsultimit publik të kryhen konform ligjit dhe të nxitet sa më shumë pjesmarrja qytetare. Një rol të veçantë në shprëndarjen e informacionit dhe organizimin e sa më shumë pjesmarrësve në procese kanë Organizatat vendore dhe persona aktiv në komunitet.

Gjetjet e studimit tregojnë se qytetarët janë shumë pak të angazhuar në proceset konsultuese, dhe në rastet kur thonë se kanë marrë pjesë, ata shpesh theksojnë se zëri i tyre nuk dëgjohej, ose se shumë nga rekomandimet e tyre nuk zbatohen.


9.2 Perceptimet e qytetarëve përmes vlerësimit online.

U përgatitën dhe u shpërndanë pyetësor online në 10 bashki, ku Rrjeti POP punon, për të parë perceptimin e qytetarëve të ndryshëm në lidhje me njohuritë ose praktikën e tyre për njoftimin dhe konsultimin publik. Pyetësorët u shpërndanë në mediat sociale të Rrjetit dhe organizatave lokale me qëllim vlerësimin e impaktit që qytetarët kanë në këtë proces.


Sipas të dhënave të mbledhura në Pukë, pyetësorit online i janë përgjigjur gjithsej 104 qytetarë nga Puka, të ndarë sipas zonave si më poshtë:

- 79 qytetarë nga zona urbane, që përbëjnë shumicën e përgjigjeve.
- 25 qytetarë nga zona rurale.


Kjo ndarje tregon një pjesëmarrje më të lartë nga qytetarët që jetojnë në zonën urbane në krahasim me ata që jetojnë në zonat rurale por gjithashtu mund të tregojë edhe largimin nga zonat rurale apo edhe mungesën e telefonave smart apo/dhe internetit.



Nga të dhënat e anketimit, është evidentuar se pjesëmarrja e qytetarëve në këtë studim ka përfshirë 57 femra dhe 46 meshkuj, ndërsa një pjesëmarrës zgjodhi të mos përgjigjet në pyetjen lidhur me gjininë. Kjo tregon se femrat kanë pasur një përfaqësim më të lartë në këtë pyetësor, me një diferencë prej 11 personash më shumë krahasuar me meshkujt. Këto të dhëna pasqyrojnë një angazhim më të madh të femrave në procesin e konsultimit publik.



Të dhënat e anketimit tregojnë se pjesëmarrësit janë ndarë sipas grupmoshave dhe gjinisë. Në



grupmoshën 15-29 vjeç, ishin 15 meshkuj dhe 17 femra, duke treguar një pjesëmarrje të ngjashme midis të dy gjinive. Në grupmoshën 30-45 vjeç, pati një rritje të ndjeshme të pjesëmarrjes së femrave me 23, krahasuar me 16 meshkuj. Për grupmoshën 46-65 vjeç, pjesëmarrja ishte e barabartë, me nga 14 persona për secilën gjini. Ndërsa në grupmoshën mbi 65

vjeç, pati vetëm 1 pjesëmarrës mashkull dhe 3 femra. Këto të dhëna tregojnë një përfaqësim të lartë të femrave në moshat 30-45 vjeç dhe një pjesëmarrje të qëndrueshme të tyre në grupmoshat e tjera.

Në lidhje me njohurinë mbi Ligjin për Konsultimin Publik, të dhënat tregojnë një diversitet në përgjigjet e pjesëmarrësve sipas gjinisë dhe moshës.


- Në grupmoshën 15-29 vjeç, 7 meshkuj dhe 6 femra raportuan se ishin të njohur me ligjin, ndërsa 8 meshkuj dhe 11 femra pohuan se nuk ishin të njohur. Kjo tregon një mungesë më të madhe të njohurive për femrat në këtë grupmoshë.

- Në grupmoshën 30-45 vjeç, njohuria mbi ligjin është më e lartë, me 10 meshkuj dhe 14 femra që deklaruan se janë të njohur, ndërsa 6 meshkuj dhe 9 femra nuk ishin të njohur. Kjo grupmoshë, veçanërisht për femrat, tregon një nivel më të lartë të njohurive mbi ligjin.

- Për grupmoshën 46-65 vjeç, 3 meshkuj dhe 8 femra pohuan se e njihnin ligjin, ndërsa një numër më i madh, 11 meshkuj dhe 6 femra, nuk ishin të njohur me të. Kjo sugjeron se në këtë grupmoshë, meshkujt kanë më pak njohuri mbi ligjin.

- Në grupmoshën mbi 65 vjeç, vetëm 1 femër raportoi se ishte e njohur me ligjin, ndërsa pjesa tjetër, përkatësisht 1 mashkull dhe 2 femra, nuk ishin të njohur.

Këto rezultate tregojnë se njohuria mbi Ligjin për Konsultimin Publik varion ndjeshëm midis grupeve të ndryshme të moshës dhe gjinisë, me një nivel më të ulët të njohurive në grupmoshat më të reja dhe më të vjetra, dhe një nivel më të lartë në grupmoshën 30-45 vjeç, veçanërisht për femrat.



Në lidhje me pjesëmarrjen në dëgjesat e organizuara nga Bashkia ose Këshilli Bashkiak gjatë dy viteve të fundit, të dhënat tregojnë se pjesëmarrja është relativisht e ulët dhe varion ndjeshëm sipas moshës dhe gjinisë.


- Në grupmoshën 15-29 vjeç, vetëm 2 meshkuj dhe 5 femra raportuan se kishin marrë pjesë në dëgjesa. Një shumicë dërrmuese, 13 meshkuj dhe 12 femra, pohuan se nuk kishin marrë pjesë fare. Kjo sugjeron një përfshirje të ulët të të rinjve në proceset e dëgjësive publike.

- Në grupmoshën 30-45 vjeç, pjesëmarrja është pak më e lartë, me 6 meshkuj dhe 7 femra që raportuan pjesëmarrje, por përsëri një numër i madh, përkatësisht 10 meshkuj dhe 16 femra, pohuan se nuk kishin marrë pjesë. Kjo tregon një angazhim më të lartë, por ende të kufizuar, në këtë grupmoshë.

- Në grupmoshën 46-65 vjeç, 3 meshkuj dhe 5 femra deklaruan se kishin marrë pjesë në dëgjesa, ndërsa 11 meshkuj dhe 7 femra pohuan mungesë pjesëmarrjeje. Dy femra në këtë grupmoshë nuk dhanë përgjigje. Ky grupmoshë gjithashtu tregon një nivel të ulët pjesëmarrjeje.

- Në grupmoshën mbi 65 vjeç, asnjë meshkuj nuk raportoi pjesëmarrje, njëjtë 3 femra pohuan se nuk kishin marrë pjesë. Një meshkull në këtë grupmoshë nuk dha përgjigje.

Këto rezultate tregojnë se pjesëmarrja në dëgjesat publike të organizuara nga Bashkia ose Këshilli Bashkiak është relativisht e ulët në të gjitha grupmoshat dhe gjinitë, me një tendencë të veçantë të pjesëmarrjes së ulët në grupmoshën më të re dhe më të vjetër.




Në lidhje me mënyrat e njoftimit për dëgjesat publike, të dhënat tregojnë preferenca dhe burime të ndryshme informacioni midis gjinisë.

- **Njoftimet nga regjistri elektronik/faqja web e bashkisë:** 3 meshkuj dhe 5 femra e marrin informacionin përmes këtij burimi, duke treguar një përdorim të moderuar të kësaj metode, veçanërisht nga femrat.

- **Posta elektronike:** 2 meshkuj dhe 3 femra deklarojnë se marrin njoftime përmes postës elektronike. Kjo sugjeron që kjo metodë është përdorur, por nuk është dominante.
- **Lajmërim i publikuar afishuar në ambientet e bashkisë:** Vetëm 1 mashkull dhe asnjë femër nuk e përdor këtë burim për njoftime, duke treguar një nivel shumë të ulët të përdorimit të kësaj metode.
- **Lajmërim në mediat audio-vizive lokale:** 3 meshkuj dhe 7 femra marrin informacion përmes mediave lokale, duke treguar se kjo metodë është më e popullarizuar tek femrat.
- **Mediat Sociale:** 7 meshkuj dhe 9 femra e marrin informacionin për dëgjesat publike përmes mediave sociale, duke e bërë këtë metodë njoftimi më të përdorurën nga të dy gjinitë, veçanërisht nga femrat.
- **Lajmërimet individuale:** 2 meshkuj dhe 5 femra raportojnë se janë informuar përmes lajmërimëve individuale, që tregon se kjo metodë është e përdorur kryesisht nga femrat.
- **Njoftim nga administratori, kryeplaku, ndërlidhësi komunitar:** 4 meshkuj dhe 3 femra deklarojnë se janë informuar përmes kësaj metode, duke treguar se kjo metodë është përdorur pak më shumë nga meshkujt.

Në përfundim, të dhënat tregojnë se mediat sociale dhe mediat audio-vizive lokale janë metodat kryesore të njoftimit për dëgjesat publike, me femrat që kanë tendencë të përdorin më shumë këto burime informacioni në krahasim me meshkujt. Ndërkohë, metoda tradicionale si njoftimet në ambientet e bashkisë ose lajmërimet individuale kanë një përdorim shumë të ulët.




Në lidhje me besimin në përmirësimin e vendimmarrjes përmes procedurave të konsultimit publik, të dhënat tregojnë se:

- **40 femra** besojnë se konsultimet publike mund të përmirësojnë vendimmarrjen, ndërsa **16 femra** janë skeptike ndaj kësaj ideje. Vetëm **1 femër** nuk ka dhënë përgjigje për këtë pyetje.

- **31 meshkuj** shprehin besim në ndikimin pozitiv të konsultimeve publike në vendimmarrje, ndërsa **15 meshkuj** nuk ndajnë të njëjtin mendim. Asnjë nga meshkujt nuk ka lënë pyetjen pa përgjigje.

Kjo tregon se në përgjithësi, femrat kanë një nivel më të lartë besimi në procedurat e konsultimit publik për përmirësimin e vendimmarrjes krahasuar me meshkujt, megjithatë, një përqindje e konsiderueshme në të dy grupet mbetet skeptike.



10. Konkluzione dhe Rekomandime

- Proceset e njoftimit, informimit dhe konsultimit publik vlerësohen nga Bashkia dhe atë cilat ndihmojnë në informimin e publikut, janë: këndet e informimit në ambientet e Bashkisë, faqja zyrtare e Bashkisë dhe mediat sociale.
- Bashkia Pukë ka një regjistër elektronik të publikuar online, i cili nuk përditësohet. Raportet vjetore në lidhje me transparencën në procesin e vendimmarrjes hartohen dhe publikohen çdo vit nga Bashkia. Pavarisht arritjeve të deritanishme, realizimi i procesit të konsultimit publik ka ende nevojë për përmirësime. Kjo mund të arrihet duke nxitur interesin e qytetarëve dhe duke krijuar infrastrukturë që mundëson informimin sa më gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm nga të gjithë.
- Nëpunësit e Bashkisë dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak duhet të marrin trajnime të vazhdueshme në lidhje me detyrimet ligjore për informimin e publikut. Në këtë mënyrë mundësohet aftësimi i vazhdueshëm i tyre në lidhje me këtë kuadër ligjor dhe ndihmon në procesin e komunikimit dhe transparencës.
- Bashkia Pukë në faqen e saj te web-it përmban Programin e Transparencës dhe një regjistër elektronik si dhe atë të kërkesave dhe ankesave por duhet përditësuar. Kjo tregon që Bashkia Pukë është transparente me qytetarët e saj.

Për të përmirësuar procesin e konsultimit publik:

- **Përmirësimi i Infrastrukturës së Informacionit:** Krijimi i një portali të dedikuar për konsultime publike, ku qytetarët mund të kenë akses në dokumentet relevante dhe të japin mendimet e tyre në mënyrë të organizuar.
- **Rritja e vizibilitetit të informacionit të dhënë nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiak** Bashkia të gjejë mënyra të ndryshme dhe sa më të arritshme tek qytetarët për mbledhjet, vendimet dhe projektligjet të cilat do shqyrtojnë/hartojë ose të miratojnë për qytetarët e

Pukës. Kjo do të uli numrin e mosinformimit dhe dezinformimit tek qytetarët dhe do rrisë pjesëmarrjen e tyre.

- **Rritja e Ndërgjegjësimit:** Fushata të vazhdueshme informimi përmes takimeve periodike, mediave sociale dhe lokale për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për proceset e konsultimit publik.
- **Trajnime të Vazhdueshme:** Organizimi i trajnimeve periodike për nëpunësit e Bashkisë dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak për t'i mbajtur ata të azhornuar me praktikat më të mira dhe detyrimet ligjore.
- **Pjesëmarrja Gjithëpërfshirëse:** Sigurimi i infrastrukturës dhe ofrimi i asistencës për personat me aftësi të kufizuara për të siguruar pjesëmarrje sa më të gjerë dhe gjithëpërfshirëse.

11. Referenca (Lista e burimeve të përdorura për studimin)

- <https://bashkiapuke.gov.al/>
- <https://bashkiapuke.gov.al/programi-transparences/>
- <https://bashkiapuke.gov.al/transparenca-dhe-llogaridhenia-ekonomiko-financiare/>
- <https://bashkiapuke.gov.al/pjesemarrja-qytetare-ne-vendimmarrje/>
- <https://bashkiapuke.gov.al/konsultimet-publike/>
- <https://bashkiapuke.gov.al/procesi-vendim-marres-i-keshillit-bashkiak/>
- https://bashkiapuke.gov.al/ep-content/uploads/2024/07/PI_Bashkia-Puke-1.pdf

12. Aneksë

Aneksi 1. Kërkesë Zyrtare drejtuar Bashkisë Pukë

Aneksi 2. Përgjigje zyrtare nga bashkia Pukë

Aneksi 3. Pyetësori i Intervistave të thelluara me stafin e Bashkisë Pukë

Ankesi 4. Pyetësori i Intervistave të thelluara me anëtarët e Këshillit Bashkiak Pukë

Ankesi 5. Pyetësori i Intervistave të thelluara me grupet e interesit

Ankesi 6. Pyetësori për qytetarët online



Nr. 1 prot.

Data 30. 05. 2024

Kërkesë për informim

Drejtuar: **z. Rrok Dodaj** Kryetar i Bashkisë Pukë

I nderuar z.Kryetar,

Qendra "Levizja Rinore per Demokraci" Pukë, si pjesë e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) <https://popnetëork.al/> po realizon një studim për zbatimin e procesit të Konsultimit Publik në Bashkinë Pukë për periudhën shtator 2023 – maj 2024.

Përsa më sipër në bazë të nenit 3, të ligjit Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", dhe nenit 6, nenit 9 dhe nenit 10 (e nene të tjera të përmendura në vijim" të ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" kërkojmë të na informoni bazuar në kërkesat si më poshtë:

Kërkesë nr. 1


1. Emrin, kontaktet e Koordinatorit të njoftimit dhe konsultimit publik dhe kopje të vendimit të emërimit të tij.
2. Linkun e regjistrit elektronik ku janë publikuar Projekt-aktet, e njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projekt-akteve sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 6, pika 1, gërma a) e ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik",
